



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07/IA007 & IA008

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Kai Ambos  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 6 prill 2022

**Gjuha e origjinalit:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim Përmbledhës mbi Apelet e Nasim Haradinajt kundër Vendimeve mbi  
Rishikimin e Paraburgimit**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Xhek Smith

**Mbrojtjes së Hysni Gucatit:**  
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:**  
Tobi Kadman

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),<sup>1</sup> duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim dy apele të dorëzuara përkatësisht më 31 dhjetor 2021 dhe 2 mars 2022 nga Nasim Haradinaj (“Apeli i Parë”, “Apeli i Dytë”, së bashku “Apelet”, dhe përkatësisht, “Haradinaj” ose “i akuzuari”),<sup>2</sup> kundër “Vendimit [Vendimeve] për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt” të datës 21 dhjetor 2021 dhe 21 shkurt 2022 (“Vendimi i Apeluar i Parë” dhe “Vendimi i Apeluar i Dytë”).<sup>3</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) iu përgjigj Apelit të Parë më 14 janar 2022 dhe Apelit të Dytë më 11 mars 2022, ku i kërkoi Panelit të Apelit që të hidhte poshtë Apelet (përkatësisht, “Përgjigjja e Parë” dhe “Përgjigjja e Dytë”).<sup>4</sup> Meqenëse shumë pika të trajtuara në Apele janë të ngjashme,<sup>5</sup> dhe duke marrë parasysh të drejtat e të akuzuarve si edhe administrimin efikas të procesit gjyqësor dhe shpejtësinë e gjykimit, Paneli do t’i shqyrtojë Apelet njëkohësisht.

---

<sup>1</sup> F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 5 janar 2022 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 5 prill 2022); F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 7 mars 2022.

<sup>2</sup> F00001, Apel kundër Vendimi F00507 të Refuzimit të Lirimit të Përkohshëm të Nasim Haradinajt, 31 dhjetor 2021 (konfidencial) (“Apeli i Parë”); F00001, Apel kundër Vendimi F00563 të Refuzimit të Lirimit të Përkohshëm të Nasim Haradinajt, 2 mars 2022 (“Apeli i Dytë”).

<sup>3</sup> F00507/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt, 21 dhjetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 21 dhjetor 2021) (“Vendimi i Apeluar i Parë”); F00563, Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt, 21 shkurt 2022 (“Vendimi i Apeluar i Dytë” dhe “Vendimi i Apeluar i Dytë”).

<sup>4</sup> F00003, Përgjigje ndaj Apelit të Mbrojtjes së Haradinajt mbi Vendimin mbi Paraburgimin të Dhjetorit 2021, 14 janar 2022 (konfidenciale) (“Përgjigjja e Parë”); F00003, Përgjigje nga Apelit të Mbrojtjes së Haradinajt mbi Vendimin për Paraburgimin të shkurtit 2022, 11 mars 2022 (“Përgjigjja e Dytë”).

<sup>5</sup> Për shembull, në Apelin e Dytë, Haradinaj thotë se vazhdon të mbështetet në parashtrimet e tij të mëparshme në lidhje me ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë. Shih Apeli i Dytë, para. 17-18, 29. Në të dy Apelet, Haradinaj parashtron se rreziku i pengimit të procesit u ndikua nga përfundimi i paraqitjes së provave të ZPS-së. Krahaso Apelin e Parë, para. 9, me Apelin e Dytë, para. 38-39. Shih gjithashtu Përgjigjja e Dytë, para. 1, 10-12.

## I. HISTORIKU

1. Më 25 shtator 2020, Haradinaj u arrestua në Kosovë në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm.<sup>6</sup> Më 26 shtator 2020, ai u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë (“objekti i paraburgimit”).<sup>7</sup>
2. Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm hodhi poshtë kërkesën e Haradinajt për lirim të menjëhershëm.<sup>8</sup>
3. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën,<sup>9</sup> dhe arriti në përfundimin se ekziston dyshimi i bazuar mirë se Haradinaj është penalisht përgjegjës për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike dhe për vepra penale kundër rendit publik (“Vendimi i Konfirmimit”).<sup>10</sup> Më 14 dhjetor 2020, ZPS-ja dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>11</sup> Më 5 korrik 2021, pas Vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit në lidhje me Mocionet Paraprake<sup>12</sup> dhe në pajtim me Urdhrin e

---

<sup>6</sup> F00016, Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4), 25 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si publik më 15 tetor 2020); F00012/A03/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Fletarrestimit për Nasim Haradinajn, 26 shtator 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 24 shtator 2020, po atë ditë u riklasifikua si konfidencial dhe *ex parte*). Shih gjithashtu F00012, Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave të Transferimit, 24 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si publik më 9 tetor 2020).

<sup>7</sup> F00020, Njoftim i Pranimit të Nasim Haradinajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 26 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si publik më 15 tetor 2020).

<sup>8</sup> F00058, Vendim në lidhje me Kërkesën për Lirim të Menjëhershëm të Nasim Haradinajt, 27 tetor 2020 (*Vendimi i Parë për Paraburgimin*), para. 33; F00030, Paraqitja e Parë, Mocion Paraprak për Hedhjen Poshtë të Akuzave dhe Mocion për Lirim të Menjëhershëm, 29 shtator 2020.

<sup>9</sup> F00074/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 22 dhjetor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 11 dhjetor 2020, u riklasifikua dy herë, si rreptësisht konfidencial më 22 dhjetor 2020 dhe si konfidencial më 24 shkurt 2021) (“Vendimi i Konfirmimit”).

<sup>10</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 128, 132, 137, 141, 145, 149.

<sup>11</sup> F00075/A02, SHTOJCË 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, version i redaktuar, 14 dhjetor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 14 dhjetor 2020). Shih gjithashtu, për versionin e paredaktuar, F00075/A01, SHTOJCË 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, 14 dhjetor 2020 (rreptësisht konfidenciale, u riklasifikua si konfidenciale më 24 shkurt 2021).

<sup>12</sup> F00007, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit në lidhje me Mocionet Paraprake, 23 qershor 2021 (“Vendimi i Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake”).

Gjykatësit të Procedurës Paraprake për Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar,<sup>13</sup> ZPS-ja ka dorëzoi versionin e korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar.<sup>14</sup>

4. Më 24 dhjetor 2020, Trupi Gjykses rishikoi dhe zgjati paraburgimin e Haradinajt<sup>15</sup> – vendim që u konfirmua nga Paneli i Gjykatës së Apelit më 9 shkurt 2021<sup>16</sup> – dhe më 24 shkurt, 23 prill dhe 23 qershor 2021.<sup>17</sup> Më pas, më 23 gusht dhe 22 tetor 2021, Trupi Gjykses rishikoi dhe zgjati paraburgimin e Haradinajt.<sup>18</sup>

5. Më 26 nëntor 2021, Trupi Gjykses refuzoi mocionet e Mbrojtjes për hedhjen poshtë të akuzave sipas rregullës 130 të Rregullores (“Vendimi i Rregullës 130”).<sup>19</sup>

6. Më 25 nëntor 2021, Policia e Kosovës, pas urdhrit të Trupit Gjykses,<sup>20</sup> dha informacion lidhur me: (i) autoritetin dhe aftësinë e Policisë së Kosovës për të kufizuar lëvizjet e individëve që janë objekt i lirimit me kusht, për të monitoruar dhe kufizuar komunikimet e këtyre individëve, për të siguruar që individët të cilët janë objekt i lirimit me kusht të mos kontaktojnë dhe/ose të ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve, viktimave apo personave të lidhur me çështjen gjyqësore, dhe për administrimin e arrestit shtëpiak si edhe zbatueshmërinë e kushteve të lirimit të përkohshëm; dhe (ii)

---

<sup>13</sup> F00244, Urdhër për Dorëzimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe për një Kalendar të Dytë të Rishikuar për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake, 23 qershor 2021.

<sup>14</sup> F00251/A01/RED, Aktakuzë me më Pak Redaktime, 4 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 5 korrik 2021) (“Aktakuza”).

<sup>15</sup> F00094, Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt, 24 dhjetor 2020 (*Vendimi i Dytë për Paraburgimin*), para. 51.

<sup>16</sup> F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021 (“Vendimi i Parë i Apelit”), para. 66.

<sup>17</sup> F00144, Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt, 24 shkurt 2021 (*Vendimi i Tretë për Paraburgimin*), para. 45; F00189/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt, 23 prill 2021 (*Vendimi i Katërt për Paraburgimin*) (versioni konfidencial u dorëzua më 23 prill 2021), para. 39; F00246, Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt, 23 qershor 2021 (*Vendimi i Pestë për Paraburgimin*), para. 40.

<sup>18</sup> F00280, Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt, 23 gusht 2021 (“Vendimi i Gjashtë për Paraburgimin”), para. 40; F00391, Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt, 22 tetor 2021 (“Vendimi i Shtatë për Paraburgimin”), para. 41.

<sup>19</sup> F00450, Vendim mbi Mocionet për Rrëzimin e Akuzave, 26 nëntor 2021 (“Vendimi i Rregullës 130”).

<sup>20</sup> F00392, Urdhër drejtuar Policisë së Kosovës, 22 tetor 2021.

rastet e mëparshme në të cilat Policia e Kosovës ka zbatuar lirimin me kusht të personave të akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.<sup>21</sup>

7. Më 26 nëntor 2021, pas urdhrit të Trupit Gjykses,<sup>22</sup> Administratorja dorëzoi informacion mbi kushtet e paraburgimit që zbatoheshin për Haradinajn në objektin e paraburgimit.<sup>23</sup>

8. Më 10 dhe 15 dhjetor 2021, përkatësisht, ZPS-ja dhe Haradinaj dorëzuan parashtrimet e tyre për paraburgimin.<sup>24</sup>

9. Më 21 dhjetor 2021, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin e Apeluar të Parë, ku urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Haradinajt mbi bazën se ekziston rreziku që ai të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë vepra penale të tjetra dhe se në këtë fazë, rreziku i pengimit të procesit dhe i përsëritjes së veprave penale nuk mund të zvogëlohej mjaftueshëm me zbatimin e masave alternative të arsyeshme.<sup>25</sup> Haradinaj e apeloj këtë vendim më 31 dhjetor 2021.<sup>26</sup>

---

<sup>21</sup> F00449/eng, Përgjigje në Kërkesë me numër KSC-BC-2020-07 të datës 22 tetor 2021, 25 nëntor 2021 (konfidenciale). Përkthimi në anglishte i këtij parashtrimi u dorëzua më 2 dhjetor 2021.

<sup>22</sup> F00393, Urdhër drejtuar Administratores për Dorëzim të Informacionit mbi Regjimin e Paraburgimit, 22 tetor 2021.

<sup>23</sup> F00452/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Zyrës Administrative në pajtim me Urdhrin e Trupit Gjykses për Dorëzim të Informacionit mbi Regjimin e Paraburgimit (F00393)", parashtrimi F00452, 24 janar 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 26 nëntor 2021).

<sup>24</sup> F00490, Parashtrime Përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 10 dhjetor 2021 (konfidenciale); F00500, Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me Paraburgimin, 15 dhjetor 2021 (konfidenciale) ("Parashtrimet e Haradinajt të datës 15 dhjetor 2021").

<sup>25</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 42, 77-78, 86, 92.

<sup>26</sup> Apeli i Parë.

10. Më 14 shkurt 2022, ZPS-ja dorëzoi parashtrime përmbledhëse për rishikimin e paraburgimit,<sup>27</sup> të cilave Mbrojtja iu përgjigj më 17 shkurt 2022.<sup>28</sup>

11. Më 21 shkurt 2022, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin e Apeluar të Dytë, ku urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Haradinajt bazuar në faktin se, që nga rishikimi i fundit, lidhur me rreziqet e identifikuar “nuk ka ndryshuar asnjë nga rrethanat” që mund të ndryshojë konstatimet e bëra në Vendimin e Apeluar të Parë.<sup>29</sup> Haradinaj e apeloj këtë vendim më 2 mars 2022.<sup>30</sup>

12. Në Apelin e Parë, Haradinaj shtjellon pesë pika që kanë të bëjnë me pretendime për gabime ligjore dhe faktike dhe keqpërdorim të kompetencës diskrecionale nga ana e Trupit Gjykses.<sup>31</sup> Në Apelin e Dytë, Haradinaj shtjellon tri pika që kanë të bëjnë me gabime ligjore dhe faktike.<sup>32</sup> Haradinaj kërkon që Paneli i Gjykatës së Apelit të miratojë Apelet dhe t’ia kthejë çështjet Trupit Gjykses për rishqyrtimin e konstatimeve të tij dhe për të rivlerësuar kriteret e nenit 41(6)(a) dhe (b) të Ligjit.<sup>33</sup>

---

<sup>27</sup> F00558, Parashtrime Përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 14 shkurt 2022. Më 28 janar 2022, Paneli lëshoi urdhër për ndryshimin e afatit për parashtrimet e paraqitura në Vendimin e Apeluar të Parë dhe, ndër të tjera, udhëzoi ZPS-në që parashtrimet e veta për paraburgimin t’i dorëzonte brenda tri ditëve nga vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit ose jo më vonë se deri më 14 shkurt 2022, Mbrojtjen që të përgjigjej deri më 17 shkurt 2022, nëse dëshironte. Shih F00537/COR, Paneli, Version i Korrigjuar i Urdhrit për Ndryshimin e Afatit mbi Parashtrimet për Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit, 28 janar 2022, para. 12.

<sup>28</sup> F00560, Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve Përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 17 shkurt 2022 (“Parashtrimet e Haradinajt të datës 17 shkurt 2022”). Më 15 shkurt 2022, Paneli udhëzoi Haradinajn t’i përgjigjej Parashtrimeve të ZPS-së deri më 17 shkurt 2022. Shih F00559, Urdhër për Caktimin e Datës lidhur me Parashtrimet e Mbrojtjes për Rishikimin e Paraburgimit, 15 shkurt 2022.

<sup>29</sup> Shih më lart, para. 9; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 50-52.

<sup>30</sup> Apeli i Dytë.

<sup>31</sup> Apeli i Parë, para. 2, 34.

<sup>32</sup> Apeli i Dytë, para. 19, 57.

<sup>33</sup> Apeli i Parë, para. 34; Apeli i Dytë, para. 57.

## II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

13. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e shqyrtimit për apelet e ndërmjetme të përcaktuar në vendimin e tij të parë dhe të zbatuar në vijimësi.<sup>34</sup>

## III. ÇËSHTJE PARAPRAKE

### A. PARASHTRIME PUBLIKE

14. Paneli i Apelit vë në dukje se ndërsa Trupi Gjykues nxori versionin e redaktuar publik të Vendimit të Apeluar të Parë,<sup>35</sup> Haradinaj dhe ZPS-ja ende nuk kanë dorëzuar versionet e redaktuara publike të Apelit të Parë dhe Përgjigjes së Parë.<sup>36</sup> Paneli rikujton se të gjitha parashtrimet e dorëzuara në Dhomat e Specializuara janë publike, përveç nëse ka arsye të jashtëzakonshme për t'i mbajtur konfidenciale, dhe se parashtrimet duhet të bëhen publike sa më shpejt që të jetë e mundur.<sup>37</sup> Gjithashtu, Paneli vëren se Haradinaj thotë se Apeli i Parë i tij mund të klasifikohet si publik pasi nuk ka nevojë për redaktim<sup>38</sup> dhe ZPS-ja kërkon që Përgjigjja e Parë të riklasifikohet si publike.<sup>39</sup> Duke marrë parasysh këto parashtrime, Paneli udhëzon Zyrën Administrative që të riklasifikojë si publik Apelin e Parë dhe Përgjigjen e Parë.<sup>40</sup>

15. Gjithashtu, Paneli rikujton palët, dhe në veçanti Haradinajn, nëse që në fillim nuk ka arsye për klasifikim konfidencial, t'i dorëzojnë parashtrimet e tyre si publike.

---

<sup>34</sup> F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dh Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 4-14. Shih gjithashtu Vendimi i Parë i Apelit, para. 11-14.

<sup>35</sup> Shih më lart, poshtëshënimi 3.

<sup>36</sup> Shih më lart, poshtëshënimet 2, 4.

<sup>37</sup> Shih p.sh., KSC-BC-2020-06, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) ("Vendimi i Dytë i Apelit të *Veselit*"), para. 8-9.

<sup>38</sup> Apeli i Parë, para. 35.

<sup>39</sup> Përgjigjja e Parë, poshtëshënimi 36.

<sup>40</sup> Shih rregullën 82(5) të Rregullores.

## B. KRITERET FORMALE PËR PARAQITJE TË APELIT

16. Pavarësisht nga paralajmërimet e dhëna në disa raste në vendimet e mëparshme,<sup>41</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se në disa raste në të dy Apelet, Haradinaj përsëri nuk i përmbush kriteret formale të apelit.<sup>42</sup> Rrjedhimisht, Paneli e gjykon të arsyeshme t'i rikujtojë.

17. Që Paneli i Gjykatës së Apelit të vlerësojë argumentet e një pale në apel, pritet që ajo palë t'i paraqesë argumentet e veta në mënyrë të qartë, logjike dhe tërësore. Gjithashtu, Paneli mund t'i hedhë poshtë parashtrimet si të pabazuara pa dhënë shpjegime të mëtëjshme, në qoftë se parashtrimet e një pale janë "të pakuptueshme, kundërthënëse, të mjegullta ose kanë mangësi të tjera formale dhe të dukshme".<sup>43</sup> Paneli rikujton se "apeluesi duhet jo vetëm të paraqesë gabimin që pretendon se është kryer, por edhe të tregojë, me saktësi të mjaftueshme, se si ky gabim ka ndikuar thelbësisht vendimin e apeluar".<sup>44</sup> Funkcionet e Panelit nuk mund të realizohen me sukses dhe efikasitet nëse palët nuk paraqesin parashtrime thelbësore, të strukturuar, të qarta dhe të argumentuara mirë.

18. Duke zbatuar këto parime bazë, Paneli përcakton, në përgjithësi, se hedhja e menjëhershme poshtë e argumenteve justifikohet për: (i) argumentet që nuk kanë lidhje me Vendimin e Apeluar ose argumentet që parashtrohen për herë të parë në apel; (ii) argumentet që nuk identifikojnë konstatimet e apeluara ose keqinterpretojnë konstatimet; dhe (iii) pretendimet e pambështetura nga ndonjë provë, pretendimet e pashtjelluara, ose ato që nuk vënë në pah ndonjë gabim.<sup>45</sup> Duke u mbështetur në këto

---

<sup>41</sup> Shih Vendimi i Parë i Apelit, para. 28-29; Vendimi i Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 14-17; F00008, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit për Nxjerrje të Informacionit, 29 korrik 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 korrik 2021), para. 16.

<sup>42</sup> Shih më poshtë, para. 19. Shih gjithashtu Përgjigjja e Parë, para. 8; Përgjigjja e Dytë, para. 9-11, 20.

<sup>43</sup> Shih p.sh., Vendimi i Parë i Apelit, para. 28 dhe jurisprudencën e cituar në të; Vendimi i Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 14.

<sup>44</sup> Shih p.sh., Vendimi i Parë i Apelit, para. 28 dhe jurisprudencën e cituar në të; Vendimi i Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 14.

<sup>45</sup> Shih p.sh., Vendimi i Parë i Apelit, para. 29 dhe jurisprudencën e cituar në të; Vendimi i Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 15.



arsye, Paneli do të përcaktojë në diskutimin e tij se cilat nga argumentet e Haradinajt do të hidhen poshtë menjëherë.

19. Gjithashtu, Paneli i Gjykatës së Apelit vëren disa raste në të dy Apelet në të cilat Haradinaj nuk i mbështet argumentet e tij duke përmendur ligjin përkatës, jurisprudencën ose parashtrimet e protokolluara,<sup>46</sup> jep referenca të pasakta ose të që nuk kanë lidhje,<sup>47</sup> nuk përdor shënime në fund të faqes,<sup>48</sup> dhe/ose nuk përmend vendimin që po kundërshton.<sup>49</sup>

20. Paneli rikujton se sipas Udhëzuesit të Punës së Zyrës Administrative për “Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara në Dhomat e Specializuara të Kosovës” (“Udhëzuesi i Punës”), apelet e ndërmjetme përmbajnë veçanërisht arsyet mbi të cilat mbështetet apeli dhe argumentet në mbështetje të tyre “ku përmendet konkretisht ligji përkatës i cili shërben si bazë”.<sup>50</sup> Gjithashtu, neni 32(2) i Udhëzuesit të Punës përcakton se “referencat e parashtrimit të protokolluar, transkriptit ose burimeve të tjera shkruhen në shënimet në fund të faqes.” Sidoqoftë, në interes të drejtësisë, Paneli do të shqyrtojë parashtrimet e Haradinajt në Apele, por rikujton përsëri palët, në veçanti Haradinajn, që të zbatojnë Udhëzuesin e Punës në parashtrimet e ardhshme dhe i paralajmëron palët se herën tjetër mund t’i hedhë poshtë menjëherë parashtrimet e tyre.

---

<sup>46</sup> Shih, në veçanti, Apeli i Dytë (ku të tri pikat e apelit nuk mbështeten nga asnjë jurisprudencë).

<sup>47</sup> Shih p.sh., Apeli i Parë, poshtëshënimi 16 (nuk ekziston paragrafi që i referohet këtij vendimi), 17, 29 dhe 33 (vendimet e përmendura janë të parëndësishme për argumentet e shtjelluara aty); Apeli i Dytë, poshtëshënimi 16 (nuk ekziston paragrafi që i referohet këtij parashtrimit).

<sup>48</sup> Shih p.sh., Apeli i Parë, para. 31-33 (në Pikën 5 të Vendimit të Apeluar të Parë citohet pa asnjë referencë në poshtëshënime); Apeli i Dytë (i cili në përgjithësi nuk ka pothuajse asnjë poshtëshënim).

<sup>49</sup> Shih p.sh., Apeli i Dytë, para. 51-53 (në Pikën 3, nuk ka referenca nga Vendimi i Apeluar).

<sup>50</sup> KSC-BD-15, Udhëzues i Punës i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara në Dhomat e Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës”), neni 46(1).

## IV. DISKUTIM

## A. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME VLERËSIMIN E DYSHIMIT TË BAZUARA SIPAS NENIT 41(6)(A) TË LIGJIT (PIKA 2 E APELIT TË PARË)

## 1. Parashtrimet e palëve

21. Në Apelin e Parë, Haradinaj parashtron se, nga ana ligjore, Trupi Gjykes nuk kishte të drejtë të mbështetej në konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Konfirmimit ose në konstatimet e veta në Vendimin e Rregullës 130 për të arritur në përfundimin se ekziston dyshimi i bazuar se Haradinaj kishte kryer vepër penale.<sup>51</sup> Haradinaj argumenton se Trupi Gjykes duhej të kishte vepruar “duke vlerësuar *de novo të gjitha* provat e paraqitura deri tani në këtë çështje gjyqësore”.<sup>52</sup> Ai parashtron se një vlerësim i tillë kërkohet sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe se, duke marrë parasysh se në kohën e rishikimit ZPS-ja e kishte përfunduar paraqitjen e provave, Trupi Gjykes ishte “në pozitë më të mirë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake” për të vlerësuar ekzistencën e *dyshimit të bazuar* se një person kishte kryer krim sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.<sup>53</sup>

22. Gjithashtu, Haradinaj parashtron se kërkohet rishqyrtim pavarësisht nga konstatimet e Trupit Gjykes në Vendimin e Rregullës 130 sepse standardi ligjor është i ndryshëm nga standardi i përcaktuar sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit, i cili është “për *të bindur një vëzhgues objektiv*’ se një person *‘ka më shumë të ngjarë’* që ta ketë kryer një vepër penale se *‘mos ta kryer atë’*”.<sup>54</sup> Rrjedhimisht, fakti se Trupi Gjykes gjykoi se Haradinaj duhet të paraqiste mbrojtje në përgjigje të akuzave nuk do të thotë se ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer krim sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.<sup>55</sup>

<sup>51</sup> Apeli i Parë, para. 12, që i referohet Vendimit të Apeluar të Parë, para. 38. Shih gjithashtu Apeli i Parë, para. 21-22.

<sup>52</sup> Apeli i Parë, para. 12-14. Shih gjithashtu Apeli i Parë, para. 20-21.

<sup>53</sup> Apeli i Parë, para. 13, 15.

<sup>54</sup> Apeli i Parë, para. 17-19, që i referohet Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nenit 19.

<sup>55</sup> Apeli i Parë, para. 20.

23. ZPS-ja parashtron paraprakisht se Haradinaj nuk paraqiti argumente pse ishte e paarsyeshme që Trupi Gjykses të mbështetej në Vendimin e Konfirmimit ose Vendimin e Rregullës 130, dhe në fakt, në vendimet e mëparshme Trupi Gjykses u mbështet vazhdimisht në konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të cilat Haradinaj nuk i apeloj.<sup>56</sup> Sipas mendimit të ZPS-së, këto argumente duhet të hidhen poshtë menjëherë.<sup>57</sup> Duke qenë se Paneli i shqyrton këto argumente në bazë të themelësisë, ZPS-ja përgjigjet se qëndrimi i Haradinajt, se Trupi Gjykses duhet të paraqesë “të gjitha konstatimet faktike paraprake” në vendimet e veta mbi rishikimin e paraburgimit, e kalon standardin e nevojshëm.<sup>58</sup> ZPS-ja argumenton më tej se Vendimi i Rregullës 130 konfirmoi dhe mbështeti konstatimet e Trupit Gjykses mbi dyshimin e bazuar dhe tregon se Trupi Gjykses mori parasysh të gjitha provat që kishte.<sup>59</sup>

24. Në Apelin e Dytë, Haradinaj njoftoi se ai “vazhdon të mbështetet” në argumentet e formuluar në Apelin e Parë në lidhje me ekzistencën dhe zbatimin e dyshimit të bazuar mirë.<sup>60</sup>

25. ZPS-ja përgjigjet se ndonëse Haradinaj tha se nuk do të përsërisë argumentet e formuluar në Apelin e Parë, shumë nga argumentet e tij në Pikën 1 të Apelit të Dytë përsërisin të njëjtat argumente të bëra në Pikën 2 të Apelit të Parë. Sipas mendimit të ZPS-së, Paneli i Apelit nuk pritet që të shqyrtojë argumentet e përsëritura.<sup>61</sup>

## **2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit**

26. Paneli paraprakisht vëren se edhe pse Haradinaj nuk iu referua Vendimit të Konfirmimit në parashtrimet e tij për rishikimin e paraburgimit drejtuar Trupit

---

<sup>56</sup> Përgjigjja e Parë, para. 11, që i referohet Vendimit të Shtatë për Paraburgimin, para. 15, 22, 24.

<sup>57</sup> Përgjigjja e Parë, para. 8, 11.

<sup>58</sup> Përgjigjja e Parë, para. 12.

<sup>59</sup> Përgjigjja e Parë, para. 13. Shih gjithashtu Përgjigjja e Parë, para. 14.

<sup>60</sup> Apeli i Dytë, para. 17-18, 29.

<sup>61</sup> Përgjigjja e Dytë, para. 9-11, që krahason Apelin e Parë, para. 2(b), 12-21 me Apelin e Dytë, para. 32-35.

Gjykues, ai faktikisht argumentoi se Trupi Gjykues nuk nxori përfundim në lidhje me “dyshimin” në Vendimin e Rregullës 130.<sup>62</sup>

27. Paneli rikujton se argumentet e parashtruara për herë të parë në apel duhen hedhur poshtë menjëherë, sepse këto argumente mund të ishin parashtruar në mënyrë të arsyeshme në shkallën e parë.<sup>63</sup> Në këtë çështje, Paneli thekson se Trupi Gjykues është mbështetur vazhdimisht në konstatimet në Vendimin e Konfirmimit në lidhje me dyshimin e bazuar mirë.<sup>64</sup> Rrjedhimisht, Haradinaj mund ta kishte apeluar në mënyrë të arsyeshme mbështetjen e Trupit Gjykues në Vendimin e Konfirmimit.

28. Gjithsesi, Paneli rikujton se brenda kontekstit të kundërshtimeve për paraburgimin, Trupit Gjykues i kërkohet vetëm të përcaktojë nëse, në kohën e dhënies së vendimit për rishikimin e paraburgimit vazhdon të ekzistojë “dyshimi i bazuar se [i akuzuari] ka kryer një krim brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara”, sikurse përcaktohet në nenin 41(6)(a) të Ligjit.<sup>65</sup> Paneli kompetent nuk ka detyrimin të bëjë vlerësimin *de novo* të faktorëve për të cilët është marrë tashmë vendim në vendimin e parë për paraburgimin, por duhet t’i shqyrtojë këto arsye ose rrethana dhe të përcaktojë nëse ende ekzistojnë.<sup>66</sup> Gjithashtu, Paneli rikujton se, ndonëse rishikimi i rregullt çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk kufizohet rreptësisht në faktin nëse ka ndodhur apo jo ndryshim në rrethanat e çështjes,<sup>67</sup> një ndryshim i tillë gjithsesi mund të jetë vendimtar dhe do të merret parasysh nëse i parashtrohet Panelit ose *proprio motu*.<sup>68</sup>

29. Sikurse vuri re me të drejtë Trupi Gjykues, standardi i “dyshimit të bazuar mirë” i cili është i nevojshëm për të konfirmuar aktakuzën sipas neni 39(2) të Ligjit,

<sup>62</sup> Parashtrimet e Haradinajt të datës 15 dhjetor 2021, para. 3.

<sup>63</sup> Vendimi i Parë i Apelit, para. 29, 38. Shih gjithashtu më lart, para. 18.

<sup>64</sup> Shih Vendimi i Gjashtë për Paraburgimin, para. 16, 25; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 14-15, 22.

<sup>65</sup> Shih p.sh., Vendimi i Dytë i Apelit të *Veselit*, para. 21.

<sup>66</sup> Shih Vendimi i Parë i Apelit, para. 55. Shih Apeli i Parë, para. 12-13.

<sup>67</sup> Shih Apeli i Parë, para. 13.

<sup>68</sup> Vendimi i Dytë i Apelit të *Veselit*, para. 14.

është më i lartë se standardi i “dyshimit të bazuar” i përcaktuar në nenin 41(6)(a) të Ligjit.<sup>69</sup> Gjithashtu, dhe në kundërshtim me pretendimin e Haradinajt, Paneli gjykon se në vlerësimin e *aftësisë* së provave për të vërtetuar fajësinë përtej dyshimit të arsyeshëm në Vendimin e Rregullës 130, Trupi Gjykses nuk zbatoi një standard më të ulët se ai që u zbatua për të vlerësuar ekzistencën e dyshimit të bazuar.<sup>70</sup> Gjithsesi, kjo pyetje nuk ka lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses. Në fakt, konkluzioni i arritur në përfundim të paraqitjes së provave të Prokurorisë se provat e marra nga Trupi Gjykses, nëse pranoheshin, mund të shërbenin si bazë për dhënien e vendimit të fajësisë për veprën penale, nuk cenon ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë ose dyshimit të bazuar, por, përkundrazi, e konfirmon atë.

30. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjykses me të drejtë arriti në përfundimin se konstatimet në Vendimin e Rregullës 130 konfirmojnë dhe mbështesin konstatimin se ende ekziston dyshimi i bazuar sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.<sup>71</sup> Mbështetja e Trupit Gjykses në këtë vendim ishte plotësisht e përshtatshme.

31. Duke u kthyer te argumentet e Haradinajt se Trupit Gjykses iu kërkua të vlerësonte të gjitha provat që kishte në kohën e rishikimit të paraburgimit, dhe të shqyrtonte nëse ZPS-ja kishte paraqitur prova të mjaftueshme për të vërtetuar të gjitha elementet e krimeve edhe para paraqitjes së provave të Mbrojtjes,<sup>72</sup> Paneli kupton se Haradinaj kundërshton provat e paraqitura nga ZPS-ja në gjykim. Paneli rikujton se në bazë të nenit 41(6) të Ligjit dhe përcaktimit të kushteve për lirim të përkohshëm ose kërkesave për rishikimin e paraburgimit, as Trupi Gjykses dhe as Paneli i Gjykatës së Apelit nuk priten që të shqyrtojnë themelësinë e çështjes dhe provat e përgjithshme të paraqitura nga ZPS-ja, ose në përgjithësi nga palët, gjatë gjykimit.<sup>73</sup> Rrjedhimisht,

---

<sup>69</sup> Shih Vendimi i Apeluar i Parë, para. 24; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 27. Shih gjithashtu Vendimi i Dytë i Apelit të *Veselit*, para. 21.

<sup>70</sup> Shih Vendimi i Rregullës 130, para. 18-19. Shih Apeli i Parë, para. 17-20.

<sup>71</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 25, 27; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 27-28.

<sup>72</sup> Apeli i Parë, para. 12, 14-16.

<sup>73</sup> Shih në kontekstin e fazës së procedurës paraprake, Vendimi i Dytë i Apelit të *Veselit*, para. 23 dhe jurisprudencën e cituar në të.

Paneli i Apelit pajtohet me Trupin Gjykses se “vlerësimi i plotë i provave të pranuar në gjykim bëhet në përfundim të gjyqimit”.<sup>74</sup>

32. Pavarësisht nga konstatimet e mësipërme, Paneli gjykon se mbështetja e Trupit Gjykses në Vendimin e Rregullës 130 tregon se Trupi Gjykses mori parasysh të gjitha provat e paraqitura në kohën e rishikimit të paraburgimit.<sup>75</sup> Kjo konfirmohet nga konstatimet e Trupit Gjykses në Vendimin e Apeluar të Dytë, se “nuk duket se provat e paraqitura nga palët deri në mbylljen e procedurës së provave e zhvlerësojnë konstatimin se ende ekziston dyshimi i bazuar brenda kuptimit të nenit 41(6)(a) të Ligjit.”<sup>76</sup>

33. Duke marrë parasysh sa më lart, Paneli hedh poshtë argumentet e Haradinajt në Pikën 2 të Apelit të Parë.

## B. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME VLERËSIMIN E NENIT 41(6)(B) TË LIGJIT

### 1. Neni 41(6)(b)(ii) i Ligjit (Pikat 1 dhe 3 të Apelit të Parë, Pika 1 e Apelit të Dytë)

#### (a) Parashtrimet e palëve

34. Në Apelin e Parë, Haradinaj parashtron se në Vendimin e Apeluar të Parë, Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe shpërdoroi kompetencën e vet kur konstatoi se, nëse do të lirohej, Haradinaj do ta pengonte këtë proces.<sup>77</sup> Haradinaj argumenton se ky përfundim është i paarsyeshëm dhe i palogjikshëm pasi edhe në rast të shpërndarjes së informacionit që i është nxjerrë atij, ai “nuk do të ishte në gjendje të shkatërronte, fshihte, ndryshonte apo falsifikonte provat e paraqitura tashmë Trupit Gjykses”, dhe ZPS-ja do të vazhdonte me paraqitjen e provave të veta pavarësisht nga veprimet ose mosveprimet e tij apo të ndonjë bashkëpunëtori të pretenduar të tij.<sup>78</sup>

<sup>74</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 26. Shih Apeli i Parë, para. 16.

<sup>75</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 25.

<sup>76</sup> Vendimi i Dytë i Apelit, para. 27.

<sup>77</sup> Apeli i Parë, Pika 1, para. 9.

<sup>78</sup> Apeli i Parë, para. 9.

Haradinaj parashtron më tej se ZPS-ja nuk paraqiti prova që tregojnë se ai ka kërcënuar, ndërhyrë ose kontaktuar ndonjë dëshmitar apo viktimë.<sup>79</sup> Haradinaj rikujton se nuk është detyra e të akuzuarit të paraqesë arsyet që përligjin lirimin e tij, por e ZPS-së, dhe rreziku që një i akuzuar të pengojë procesin duhet të mbështetet në prova faktike.<sup>80</sup>

35. Haradinaj parashtron gjithashtu se, nga ana ligjore, Trupi Gjykses nuk kishte të drejtë të mbështetej në konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Konfirmimit për të arritur në përfundimin se ekzistonin arsye të artikulueshme për të besuar se, nëse do të lirohej, Haradinaj do të pengonte procesin.<sup>81</sup> Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses duhej të kishte vepruar “duke vlerësuar *de novo të gjitha* provat e paraqitura deri më tani në këtë çështje” në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit,<sup>82</sup> dhe se, pasi ZPS-ja të kishte përfunduar paraqitjen e provave të saj, Trupi Gjykses do të ishte në “pozitë më të mirë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake” për të vlerësuar ekzistencën e *arsyeve të artikulueshme për të besuar* se i akuzuari do të pengonte procesin.<sup>83</sup> Gjithashtu, Haradinaj parashtron se duke u mbështetur në konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Trupi Gjykses nuk mori parasysh faktet përkatëse që ndikonin materialisht në vendim, përkatësisht, nëse ZPS-ja dorëzoi prova të pranueshme, të besueshme dhe ku mund të mbështetej për të vërtetuar se Haradinaj ka ndërhyrë ose ka kërcënuar dëshmitarët, sikurse pretendohet.<sup>84</sup>

36. Fillimisht, ZPS-ja përgjigjet se argumenti i Haradinajt se rreziku i pengimit të procesit ndikohej nga përfundimi i paraqitjes së provave të ZPS-së nuk iu paraqit asnjëherë Trupit Gjykses dhe për këtë arsye duhet të hidhet poshtë menjëherë.<sup>85</sup> Nëse

---

<sup>79</sup> Apeli i Parë, para. 10. Shih gjithashtu Apeli i Parë, para. 24.

<sup>80</sup> Apeli i Parë, para. 11.

<sup>81</sup> Apeli i Parë, Pika 3, para. 22, që i referohet Vendimit të Apeluar të Parë, para. 38. Shih gjithashtu Apeli i Parë, para. 24.

<sup>82</sup> Apeli i Parë, para. 22, 25.

<sup>83</sup> Apeli i Parë, para. 23.

<sup>84</sup> Apeli i Parë, para. 24-25.

<sup>85</sup> Përgjigja e Parë, para. 8-9.

ky argument merret parasysh në lidhje me themelësinë, ZPS-ja argumenton se rreziku i pengimit të procesit mund të vazhdojë të ekzistojë gjatë të gjithë procesit, duke përfshirë dhe kohën pas përfundimit të paraqitjes së provave nga ZPS-ja, dhe në veçanti duke marrë parasysh informacionin tejet të ndjeshëm të marrë nga i akuzuari kohët e fundit.<sup>86</sup> Së fundi, ZPS-ja parashtron se Haradinaj nuk pretendon se ka gabim kur argumenton se ZPS-ja nuk arriti të provojë se ai ka kërcënuar ose ndërhyrë ndaj dëshmitarëve ose viktimave; ai thjesht nuk pajtohet me dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer krimet për të cilat akuzohet.<sup>87</sup>

37. Në Apelin e Dytë, Haradinaj parashtron se Trupi Gjykses nuk arriti të identifikonte arsye konkrete në mbështetje të ekzistencës së rrezikut se Haradinaj do të pengonte procesin nëse lirohej.<sup>88</sup> Së pari, Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses bëri gabim kur përdori ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë për plotësimin e kushteve të nenit 41(6)(a) dhe (b)(ii) të Ligjit.<sup>89</sup> Për mendimin e tij, kjo “llogaritje e dyfishtë” e bën të mjaftueshme ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë për ta mbajtur të akuzuarin në paraburgim dhe e bën të pakuptimtë procesin e rishikimit të paraburgimit.<sup>90</sup> Së dyti, Haradinaj parashtron se nuk ekziston rrezik konkret për pengimin e procesit duke marrë parasysh se (i) të vetmet dokumente përkatëse që pretendohet se ka pasur në zotërimin e tij janë sekuestruar të gjitha; dhe (ii) Prokuroria dhe Mbrojtja tashmë kanë përfunduar paraqitjen e provave të tyre, dhe të gjithë dëshmitarët kanë dëshmuar dhe të gjitha dokumentet dhe provat janë pranuar.<sup>91</sup> Së fundi, Haradinaj parashtron se e drejta e tij për të marrë pjesë në procesin kundër tij nuk duhet të përdoret për të ndërhyrë në të drejtën e tij për liri<sup>92</sup> dhe ai është i

---

<sup>86</sup> Përgjigja e Parë, para. 9. Shih gjithashtu Përgjigja e Dytë, para. 16.

<sup>87</sup> Përgjigja e Parë, para. 10. Në përgjigje të argumentit të Haradinajt mbi mbështetjen në Vendimin e Konfirmimit, ZPS-ja the SPO shtjellon të njëjtat argumente që përdori për dyshimin e bazuar. Shih më lart, para. 23; Përgjigja e Parë, para. 11-14.

<sup>88</sup> Apeli i Dytë, para. 19(a), 30(a), 38, 43, 57(a).

<sup>89</sup> Apeli i Dytë, para. 31-33, që i referohet Vendimit të Apeluar të Dytë, para. 26.

<sup>90</sup> Apeli i Dytë, para. 33-36.

<sup>91</sup> Apeli i Dytë, para. 37-39, që kundërshton Vendimin e Apeluar të Dytë, para. 37.

<sup>92</sup> Apeli i Dytë, para. 40.



shqetësuar se qasja e Trupit Gjykses dhe vazhdimi i paraburgimit cenon prezumimin e pafajësisë së tij.<sup>93</sup>

38. ZPS-ja përgjigjet se faktorët e marrë parasysh nga Trupi Gjykses në vlerësimin e rrezikut të pengimit të procesit, në veçanti dëshminë e Haradinajt, gjatë të cilës deklaroi se do të shpërndante më shumë dokumente nëse do t'i merrte ato, ishin konkretë, specifikë dhe të arsyeshëm.<sup>94</sup> Sipas mendimit të ZPS-së, të njëjtat fakte që mbështesin ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë në këtë çështje tregojnë gjithashtu një rrezik të qartë sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit.<sup>95</sup> ZPS-ja më tej përgjigjet se pavarësisht nëse Haradinajt iu morën dokumentet mbi të cilat mbështeten pretendimet për krime, rreziku i pengimit të procesit vazhdon të ekzistojë gjatë gjithë procesit, pasi atij i është treguar informacion tejet i ndjeshëm gjatë gjyqimit.<sup>96</sup>

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

39. Fillimisht, Paneli rikujton se në vlerësimin e rrezikut të pengimit të procesit nga Haradinaj, Trupi Gjykses konstatoi se: (i) ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se Haradinaj, ndër të tjera, mori pjesë dhe inkurajoi shpërndarjen e informacionit të mbrojtur dhe kërcënoi dhënësit (e mundshëm) të informacionit, dhe vazhdimisht deklaroi se do të vazhdonte ta bënte këtë, pavarësisht urdhrave të Gjykatës të Vetëm;<sup>97</sup> (ii) kohët e fundit Haradinaj ka marrë informacion tejet të ndjeshëm përmes nxjerrjes së informacionit dhe për shkak të pjesëmarrjes së tij në gjykim është gjithashtu në dijeni të një numri të shumtë provash konfidenciale, shpërndarja e të cilave do të rrezikonte sigurinë e dëshmitarëve dhe hetimet në kryerje e sipër të ZPS-së;<sup>98</sup> (iii) Haradinaj, si nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së ("OVL-UÇK"), ka mjetet për ta shpërndarë informacionin nëpërmjet mediave ose me

---

<sup>93</sup> Apeli i Dytë, para. 31-32, 41-42.

<sup>94</sup> Përgjigjja e Dytë, para. 13-15, që i referohet veçanërisht Vendimit të Apeluar të Dytë, para. 36-40, 43.

<sup>95</sup> Përgjigjja e Dytë, para. 15.

<sup>96</sup> Përgjigjja e Dytë, para. 16-17.

<sup>97</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 35; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 36.

<sup>98</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 36; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 37, 40.

ndihmën e të tjerëve në OVL-UÇK;<sup>99</sup> dhe së fundi, (iv) gjatë dëshmisë Haradinaj deklaroi se do të publikonte çdo material të Task Forcës Speciale Hetimore (“TFHS”), ZPS-së ose Dhomave të Specializuara dërguar OVL-UÇK-së.<sup>100</sup>

40. Duke trajtuar së pari argumentet e Haradinajt se rreziku i pengimit të procesit u ndikua nga përfundimi i paraqitjes së provave të ZPS-së, sikurse argumentohet nga ZPS-ja, Paneli i Apelin vëren se, Haradinaj faktikisht nuk e përfshiu këtë argument në Parashtrimet e 15 dhjetorit 2021 për Trupin Gjykses.<sup>101</sup> Rrjedhimisht, hedhja poshtë e menjëhershme e këtij argumenti në Apelin e Parë përlligjet pasi mund të ishte parashtruar në mënyrë të arsyeshme në shkallën e parë.<sup>102</sup> Gjithsesi, duke marrë parasysh se Haradinaj e ngriti këtë argument në Parashtrimet e tij të datës 17 shkurt 2022, dhe më pas në Apelin e Dytë,<sup>103</sup> Paneli e gjykon të përshtatshme ta shqyrtojë atë në kontekstin e të dy apeleve.

41. Paneli rikujton fillimisht se neni 41(6)(b) i Ligjit nuk përfshin kufij ligjor ose kohor për vlerësimin e rreziqeve, dhe në veçanti për rrezikun e pengimit të procesit.<sup>104</sup> Konkretisht, sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, paneli kompetent vlerëson nëse ekziston rreziku i pengimit “të ecurisë së procedurës penale”, dhe jo vetëm i ecurisë së gjykimit.

42. Paneli thekson se, ndërsa Dhomat e Specializuara nuk janë të detyruara të zbatojnë jurisprudencën e gjykatave dhe tribunalëve të tjerë, disa dhoma gjyqësore në TPNJ dhe GJNP kanë gjykuar se pas përfundimit të paraqitjes së provave në gjykim i akuzuari nuk përbënte më rrezik për dëshmitarët ose viktimat.<sup>105</sup> Megjithatë, në

<sup>99</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 36; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 38.

<sup>100</sup> Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 37, që i referohet transkriptit, 13 janar 2022, f. 3024, rreshtat 3-4: “[...] të njëjtë do të veproj se hala kam mendimin e njëjtë. Për qa’q sa kam vepru që kam bo drejtë [...]”.

<sup>101</sup> Krahaso Apelin e Parë, para. 9 me Parashtrimet e Haradinajt të datës 15 dhjetor 2021, para. 8-11. Shih gjithashtu Përgjigjja e Parë, para. 9.

<sup>102</sup> Shih më lart, para. 27.

<sup>103</sup> Parashtrimet e Haradinajt të datës 17 shkurt 2022, para. 38; Apeli i Dytë, para. 39.

<sup>104</sup> Shih Përgjigjja e Parë, para. 9.

<sup>105</sup> Shih p.sh., ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-1733-Corr, Corrected version of Decision on the Defence Request for Immediate Release and the Communication Restrictions Applying to the Accused, 17 April 2020, para. 25; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v Prlić et al.*, IT-04-74-T, Decision on Jadranko Prlić’s Motion for Provisional Release, 24 November 2011, para. 32. Megjithatë, Paneli thekson se në ato

çështje gjyqësore të tjera, dhomat gjyqësore kanë konstatuar gjithashtu se përfundimi i gjykimit nuk e eliminoi rrezikun e pengimit të procesit nga i akuzuari.<sup>106</sup> Sipas mendimit të Panelit, nëse gjërat do të rridhnin normalisht, rreziku i pengimit të procesit do të zvogëlohej me kalimin e kohës kur të kenë përfunduar hetimet, dëshmitarët të kenë dëshmuar dhe provat të jenë dorëzuar.<sup>107</sup> Gjithsesi, në varësi të rrethanave të çështjes gjyqësore, një rrezik i tillë mund të mos zvogëlohet gjithmonë ndjeshëm.

43. Në këtë çështje, Trupi Gjykues gjykoi, veçanërisht duke marrë parasysh sjelljen e pretenduar të të akuzuarit në të kaluarën dhe deklaratat e përsëritura se ai do të vazhdonte të shpërndante dokumente të TFHS/ZPS-së, se ekzistonte rreziku i vazhdueshëm që Haradinaj të pengonte procesin duke shpërndarë informacion konfidencial ose të mbrojtur dhe në këtë mënyrë të kërcënonte ose të ndikonte dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit.<sup>108</sup> Në kundërshtim me pretendimin e Haradinajt, është i parëndësishëm fakti se dokumentet që ai pretendohet se nxori janë sekuestruar tashmë nga ZPS-ja.<sup>109</sup> Sikurse Trupi Gjykues e pranoi qartë, Haradinaj është tashmë në dijeni, për shkak të pjesëmarrjes në gjykim, të një numri të shumtë provash inkriminuese dhe informacioni konfidencial, përfshirë materiale tejet të ndjeshme të nxjerra për Mbrojtjen në nëntor 2021. Nxjerrja e mundshme e këtyre

---

çështje gjyqësore, përfundimi i paraqitjes së provave në gjykim ishte vetëm njëri nga shumë faktorë që mbështetën një përfundim të tillë.

<sup>106</sup> Shih p.sh., ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3221, Decision on “Defence Urgent Motion for Provisional Release”, 23 December 2014, para. 38-51, confirmed on appeal in ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3249-Red, Public redacted version of Judgment on the appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo against the decision of Trial Chamber III of 23 December 2014 entitled “Decision on ‘Defence Urgent Motion for Provisional Release’”, 20 May 2015, para. 66-71. Paneli gjithashtu vëren se në çështjen *Nzabonimpa et al.* case, një gjykatës i Mekanizmit Përmbyllës Ndërkombëtar për Tribunalët Penalë konstatoi se disa nga të akuzuarit ishin fajtorë për ndërhyrje në administrimin e drejtësisë në fazën e rishikimit në çështjen *Ngirabatware*. Shih IRMCT, *Prosecutor v. Nzabonimpa et al.*, MICT-18-116-T, Judgment, 25 June 2021, para. 2-6, 409.

<sup>107</sup> Shih p.sh., ECtHR, *W. v. Switzerland*, no. 14379/88, Judgment, 26 January 1993, para. 35; ECtHR, *Clooth v. Belgium*, no. 12718/87, Judgment, 12 December 1991, para. 43; ECtHR, *Letellier v. France*, no. 12369/86, Judgment, 26 June 1991, para. 39.

<sup>108</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 35-38; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 36-40.

<sup>109</sup> Shih Apeli i Dytë, para. 46, 48.

provave ose këtij materiali do të rrezikonte sigurinë e dëshmitarëve.<sup>110</sup> Rrjedhimisht, Paneli gjykon se Trupi Gjykses nuk ka gabuar kur konstatoi se rreziku i pengimit të procesit mund të vazhdojë pas përfundimit të paraqitjes së provave nga ZPS-ja dhe, më përgjithësisht, deri në fund të gjykimit.<sup>111</sup>

44. Në lidhje me argumentet e Haradinajt mbi mosparaqitjen e pretenduar nga ZPS-ja të provave për kërcënim, ndërhyrje apo kontakte me dëshmitarët ose viktimat,<sup>112</sup> dhe për më tepër, në mbështetjen e Trupit Gjykses në Vendimin e Konfirmimit,<sup>113</sup> Paneli konstaton se në fakt Haradinaj kundërshton provat që mbështesin akuzat e konfirmuara që ZPS-ja i paraqiti në gjykim.<sup>114</sup> Paneli thekson se Haradinaj nuk ia parashtrroi këto argumente Trupit Gjykses, dhe për këtë arsye duhen hedhur poshtë menjëherë.<sup>115</sup> Gjithashtu, Paneli rikujton konstatimet e veta të bëra më lart se (i) standardi i “dyshimit të bazuar mirë” është më i lartë se standardi i “dyshimit të bazuar”; (ii) Vendimi i Rregullës 130 i Trupit Gjykses konfirmon dhe mbështet konstatimin se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit; dhe (iii) rishikimi i paraburgimit nuk është forumi i duhur për të trajtuar themelësinë e çështjes dhe tërësinë e provave të paraqitura në gjykim.<sup>116</sup> Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentet e Haradinajt.

45. Duke iu kthyer argumentit të ngjashëm të Haradinajt se Trupi Gjykses nuk duhej të kishte përdorur ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë në lidhje me plotësimin

---

<sup>110</sup> Shih Vendimi i Apeluar i Parë, para. 36, që i referohet F00413/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kundërshtimet e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3), 16 dhjetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 3 nëntor 2021), para. 95(b); F00435/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë në lidhje me Materialin 201 në Njoftimin sipas Rregullës 102(3), 16 dhjetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 15 nëntor 2021), para. 26. Shih gjithashtu Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 37.

<sup>111</sup> Paneli thekson se edhe Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit kur gjykoi se vazhdon të ekzistojë rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera. Shih Vendimi i Apeluar i Parë, para. 41; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 43.

<sup>112</sup> Apeli i Parë, para. 10.

<sup>113</sup> Apeli i Parë, para. 22-25.

<sup>114</sup> Shih gjithashtu më lart, para. 31.

<sup>115</sup> Shih gjithashtu më lart, para. 26-27.

<sup>116</sup> Shih më lart, para. 28-33.

e kritereve të nenit 41(6)(a) dhe (b)(ii), Paneli vëren se Haradinaj përsëri nuk ia paraqiti këtë argument Trupit Gjykses kur në mënyrë të arsyeshme mund të ishte parashtruar në shkallë të parë.<sup>117</sup> Megjithatë, dhe sikurse u konstatua më lart,<sup>118</sup> Paneli nuk e gjykon të gabuar mbështetjen e Trupit Gjykses në ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë se Haradinaj, ndër të tjera, shpërndau informacion të mbrojtur dhe kërcënoi dhënësit (e mundshëm) të informacionit, dhe për këtë arsye pretendohet se pengoi procesin e Dhomave të Specializuara, kur konstatoi se ekziston rreziku që Haradinaj ta pengojë këtë proces. Natyra shumë specifike e dyshimit të bazuar mirë, dhe për rrjedhojë e akuzave të konfirmuara, e bën atë faktor të rëndësishëm në vlerësimin e Trupit Gjykses për ekzistencën e rrezikut të pengimit të procesit, dhe për ligj atë që Haradinaj e quan “llogaritje e dyfishtë”.<sup>119</sup> Gjithashtu, Paneli gjykon se ekzistenca e dyshimit të bazuar mirë ishte një nga faktorët e marrë parasysh nga Trupi Gjykses.<sup>120</sup>

46. Duke u kthyer te argumenti i Haradinajt në lidhje me njohurinë që kishte për provat për shkak të pjesëmarrjes së tij në gjykim,<sup>121</sup> Paneli rikujton se ndonëse nxjerrja e provave mund të jetë faktor i rëndësishëm, është vetëm një ndër faktorët që mund të merret parasysh në marrjen e vendimit nëse është i domosdoshëm vazhdimi i paraburgimit.<sup>122</sup> Sidoqoftë, ky faktor në vetvete nuk mjafton për të për ligjur refuzimin e lirimit të përkohshëm. Paneli vëren se në Vendimin e Apeluar të Dytë, Trupi Gjykses

<sup>117</sup> Shih Parashtrimet e Haradinajt të datës 17 shkurt 2022. Trupi Gjykses u mbështet në këtë faktor në Vendimin e Gjashtë për Paraburgimin, në para. 25, dhe në Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, në para. 22.

<sup>118</sup> Shih më lart, para. 44.

<sup>119</sup> Gjithashtu, Paneli gjykon se një argument i tillë nuk ka lidhje me kontekstin e rishikimit të paraburgimit. Në fakt, ndalimi i “llogaritjes së dyfishtë” zbatohet në kontekstin e dënimit ku të njëjtët faktorë (inkriminues) nuk mund të llogariten dy herë (ose më shumë) si bazë e akuzës dhe më pas përsëri në kontekstin e dënimit në dëm të të akuzuarit. Me fjalë të tjera, “çdo faktor – jo thjesht një element përbërës i veprës penale – i marrë tashmë parasysh në lidhje me përkufizimin e veprës penale nuk duhet të konsiderohet (‘llogaritet’) përsëri si rrethanë rënduese gjatë caktimit të dënimit”. Shih Ambos, K. *Treatise on International Criminal Law: Volume II: The Crimes and Sentencing*, (First Edition) 2014, pp. 288-289; (Second Edition) 2022, pp. 329-330 with further references therein.

<sup>120</sup> Shih më lart, para. 39; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 36-39. Shih gjithashtu Vendimi i Apeluar i Parë, para. 35-37.

<sup>121</sup> Apeli i Dytë, para. 40.

<sup>122</sup> Vendimi i Dytë i Apelit të Veselit, para. 31.

e shqyrtoi këtë faktor së bashku me faktorë të tjerë për të përcaktuar ekzistencën e rrezikut të pengimit të procesit.<sup>123</sup>

47. Haradinaj nuk ka provuar se ishte e paarsyeshme që Trupi Gjykes u mbështet në njohuritë e tij për informacionin konfidencial që i ishte nxjerrë, për të arritur në përfundimin se, duke marrë parasysh faktorët e tjerë të shqyrtuar, shtohen rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit. Për këtë arsye, dhe në kundërshtim me pretendimin e Haradinajt,<sup>124</sup> Paneli gjykon se vlerësimi i Trupit Gjykes nuk cenon prezumimin e pafajësisë dhe nuk është në kundërshtim me të drejtat e tij procedurale themelore.<sup>125</sup>

48. Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë Pikat 1 dhe 3 të Apelit të Parë dhe Pikën 1 të Apelit të Dytë.

## 2. Neni 41(6)(b)(iii) i Ligjit (Pika 4 e Apelit të Parë dhe Pika 2 e Apelit të Dytë)

49. Paneli rikujton se kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit janë si alternativë e njëri-tjetrit.<sup>126</sup> Në qoftë se njëri nga këto kushte përmbushet, nuk është e nevojshme të shqyrtohen kushtet e tjera për vazhdimin e paraburgimit. Paneli vëren se në Pikën 4 të Apelit të Parë dhe në Pikën 2 të Apelit të Dytë, Haradinaj paraqet argumente të cilat shtjellojnë rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit.<sup>127</sup> Duke marrë parasysh se Paneli nuk konstatoi asnjë gabim në përfundimin e Trupit Gjykes se vazhdonte të ekzistonte rreziku i pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, gjë që e bënte vazhdimin e paraburgimit të domosdoshëm, nuk është e nevojshme që ai të shqyrtojë pretendimin për gabime sipas

<sup>123</sup> Shih më lart, para. 39; Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 36-39. Shih gjithashtu Vendimi i Apeluar i Parë, para. 35-37.

<sup>124</sup> Apeli i Dytë, para. 40-42.

<sup>125</sup> Paneli thekson se Trupi Gjykes iu referua qëllimisht prezumimit të pafajësisë së Haradinajt. Shih Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 22, 36.

<sup>126</sup> Shih p.sh., F00005, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021) ("Vendimi i Parë i Apelit të Thaçit"), para. 78.

<sup>127</sup> Apeli i Parë, para. 26-30; Apeli i Dytë, para. 44-50.

nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit.<sup>128</sup> Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë Pikën 4 të Apelit të Parë dhe Pikën 2 të Apelit të Dytë.

C. PRETENDIMI PËR GABIME NË VLERËSIMIN E KUSHTEVE TË LIRIMIT (PIKA 5 E APELIT TË PARË DHE PIKA 3 E APELIT TË DYTË)

### 1. Parashtrimet e palëve

50. Në Apelin e Parë, Haradinaj parashtron se në fakt Trupi Gjykses gaboi kur konstatoi se ekziston mundësia që disa individë në Policinë e Kosovës ose që kanë lidhje me të, të cilët janë, ose mund të jenë, të afërt me të akuzuarin, mund të përdorin praktika korruptuese ose të dyshimta për të ndërhyrë në realizimin e drejtësisë.<sup>129</sup> Haradinaj parashtron më tej se, në arritjen e konstatimeve të veta, Trupi Gjykses u mbështet në burime dytësore të paverifikuara dhe në vend të kësaj, Haradinaj u referohet disa burimeve publike që vlerësojnë profesionalizmin e Policisë së Kosovës.<sup>130</sup> Për më tepër, Haradinaj argumenton se, edhe nëse incidentet e pretenduara të korrupsionit konsideroheshin të besueshme, ZPS-ja dhe Trupi Gjykses nuk arritën t'ia atribuonin ato Haradinajt.<sup>131</sup>

51. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses kishte prova të shumta për të arritur në përfundimin se disa individë në Policinë e Kosovës ose që janë të lidhur me të dhe kanë lidhje me Haradinajn, mund të përdorin praktika korruptuese ose të dyshimta për të ndërhyrë në proces.<sup>132</sup> Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses gjykoi në kontekst se nuk mund të përjashtonte mundësinë e praktikave të tilla, por se ato nuk ishin përcaktuese në vlerësimin e tij.<sup>133</sup>

---

<sup>128</sup> Shih p.sh., Vendimi i Parë i Apelit të *Thaçit*, para. 78.

<sup>129</sup> Apeli i Parë, para. 31, 33.

<sup>130</sup> Apeli i Parë, para. 32.

<sup>131</sup> Apeli i Parë, para. 33.

<sup>132</sup> Përgjigjja e Parë, para. 16. Shih gjithashtu Përgjigjja e Parë, para. 17.

<sup>133</sup> Përgjigjja e Parë, para. 16.

52. Në Apelin e Dytë, Haradinaj parashtron se, duke marrë parasysh burimet dhe informacionin që zotëron, çdo rrezik që ai paraqet në qoftë se lirohet me kusht do të ishte i papërfillshëm.<sup>134</sup> Gjithashtu, Haradinaj argumenton se duke e mbivlerësuar shkallën e rrezikut që do të paraqiste në qoftë se do të lirohej, Trupi Gjykses nuk e mori parasysh siç duhet themelësinë e mundshme të kushteve të liritimit, në veçanti kufizimin e kontakteve të Haradinajt.<sup>135</sup>

53. ZPS-ja përgjigjet se Haradinaj nuk gjen ndonjë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses për kushtet e liritimit dhe pretendimet e tij janë të pabazuara.<sup>136</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

54. Duke trajtuar së pari argumentet e Haradinajt në lidhje me korrupsion të pretenduar në Policinë e Kosovës, Paneli vëren se Trupi Gjykses, në Vendimin e Apeluar të Parë, nuk konstatoi se Policia e Kosovës përdor praktika korruptuese ose të dyshimta me qëllim që të ndërhyjë në realizimin e drejtësisë, por konstatoi se bazuar në raportet e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale dhe artikujt në media, *nuk mund ta përjashtonte mundësinë e praktikave të tilla.*<sup>137</sup>

55. Paneli vëren se Trupi Gjykses theksoi shprehimisht se megjithëse shqyrtimi në kontekst nuk është “përcaktues, në vetvete, i çështjes në diskutim [...] vlerësimi i efektivitetit të kushteve të propozuara [d.m.th., kushtet e propozuara nga Policia e Kosovës] nuk mund të shkëputet plotësisht nga [ky] kontekst.”<sup>138</sup> Paneli pajtohet me Trupin Gjykses se një kontekst i tillë mund të jetë i rëndësishëm për të vlerësuar nëse kushtet e propozuara ishin të mjaftueshme për të zvogëluar rreziqet e identifikuar, dhe gjykon se, në kundërshtim me pretendimin e Haradinajt, ky faktor nuk ishte vendimtar në vlerësimin që bëri Trupi Gjykses lidhur me kapacitetin e Policisë së

---

<sup>134</sup> Apeli i Dytë, para. 51.

<sup>135</sup> Apeli i Dytë, para. 52-53. Shih gjithashtu Apeli i Dytë, para. 56.

<sup>136</sup> Përgjigjja e Dytë, para. 20.

<sup>137</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 80. Shih gjithashtu Përgjigjja e Parë, para. 16.

<sup>138</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 81.



Kosovës për të zbatuar kushtet.<sup>139</sup> Rrjedhimisht, konstatimet e Panelit lidhur me këtë aspekt nuk do të kishin ndikim në Vendimin e Apeluar të Parë. Paneli i Apelit thekson se pas vlerësimit tërësor të parashtrimeve të dorëzuara nga Policia e Kosovës, Zyra Administrative dhe palët, Trupi Gjykses gjykoi se kushtet e renditura të propozuara nuk mund ta zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun që Haradinajt të pengonte ecurinë e procesit ose të kryente vepra penale të tjera.<sup>140</sup>

56. Në vijim, Paneli do të kalojë në shqyrtimin e argumenteve të Haradinajt në lidhje me Vendimin e Apeluar të Dytë se Trupi Gjykses duke e mbivlerësuar shkallën e rrezikut që ai paraqiste, nuk mori parasysh siç duhet mundësinë e lirimit me kusht ose kushteve të tjera për lirim të propozuara nga Mbrojtja.<sup>141</sup> Fillimisht, Paneli vëren se Haradinaj nuk arrin të identifikojë konstatimet e apeluara si dhe të identifikojë qartë dhe të shtjellojë gabimet e pretenduara të Trupit Gjykses.<sup>142</sup> Gjithsesi, Paneli rikujton se nuk ka konstatuar ndonjë gabim të Trupit Gjykses në vlerësimin e rrezikut.<sup>143</sup> Gjithashtu, Paneli merr parasysh se Trupi Gjykses konstatoi se kushtet e propozuara, që përfshijnë më shumë masa se dorëzania dhe kufizimi i kontakteve siç propozohet nga Haradinaj,<sup>144</sup> ishin të pamjaftueshme për zvogëlimin e rreziqeve që Haradinaj të pengonte procesin ose të kryente krime të tjera.<sup>145</sup> Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi kur hodhi poshtë kushtet e propozuara nga Mbrojtja.

57. Duke marrë parasysh sa më lart, Paneli gjykon se Haradinaj nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e kushteve të lirimit. Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës së Apelit hedh poshtë Pikën 5 të Apelit të Parë dhe Pikën 3 të Apelit të Dytë.

---

<sup>139</sup> Shih Apeli, para. 33.

<sup>140</sup> Vendimi i Apeluar i Parë, para. 56-78.

<sup>141</sup> Apeli i Dytë, para. 51-53.

<sup>142</sup> Shih më lart, para. 18-19.

<sup>143</sup> Shih më lart, para. 39-49.

<sup>144</sup> Shih Apeli i Dytë, para. 51-52.

<sup>145</sup> Vendimi i Apeluar i Dytë, para. 51-52. Shih gjithashtu Vendimi i Apeluar i Parë, para. 77-78.

VENDIM

58. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**HEDH POSHTË** Apelin e Parë dhe të Dytë; dhe

**UDHËZON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publik Apelin e Parë të Haradinajt dhe Përgjigjen e Parë të ZPS-së.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,  
Kryegjykatëse**

E mërkurë, 6 prill 2022

Në Hagë, Holandë